



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_\_ .06.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PER PROCEDUREN E HAPUR E THJESHTUAR ME MJETE ELEKTRONIKE**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim për mirëmbajtjen dhe riparim të autoveturave të Bashkisë Fier”** (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50110000-9 “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve të lidhura”.

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 543 444** (dy milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e dyzet e katër) Lekë **pa TVSH**.

Objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi të së cilëve është 1 317 267 lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen, si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

**b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 9 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, për ushtrimin e veprimtarisë servis automjetesh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, si dhe në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

## **Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:**

**2.2.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **1 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedure

prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **500 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a-** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 41, pika 3 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **500 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës

së përllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pikën 3 të nenit 41 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **5 (pesë) punonjës** për **muajin Prill 2026**. Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues (Drejtues Teknik).

**Shënim:** Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.2**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Prill 2026**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Prill 2026**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga natyra e shërbimeve që do të realizohen për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të Bashkisë Fier është gjykuar e arsyeshme që operatori ekonomik të ketë të punësuar minimalisht 5

persona, duke përfshirë stafin drejtues, specialistët që do të kryejnë shërbimin dhe stafin mbështetës.

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njësia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listëpagesës së muajit **Prill 2026** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shendetesore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Neni 11 Afatet e deklaramit dhe të pagesës), operatorët ekonomik kanë afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Përgjegjës (Drejtues) Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).*

**Shënim:** Për pikën **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.3**, më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt I kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente; *si dhe operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.* Ky kriter bazohet gjithashtu në Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen,

*depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to”.*

### **2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar**

Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të kenë të punësuar inxhinierë dhe specialistë të kualifikuar për realizimin me cilësi të shërbimeve të kërkuara, si më poshtë:

1. Inxhinier mekanik	1 (një)
2. Punonjës mekanik	1 (nje)
3. Xhenerik	1 (një)
4. Motorrist	1 (një)
5. Elektroaut	1 (një)

Aftesia profesionale e tyre duhet të jete vertetuar me diplome ose certificate profesionale ose deshmi kualifikimi si dhe me kontrate pune të vlefshme.

**Shënim:** Për pikën 2.3.4 me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.4, më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në perputhje me *zërat, natyrën, volumet e preventivit si dhe me numrin e automjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.*

**2.3.5** Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambjente, për përmbushjen e shërbimeve të kërkuara në perputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

- a. Vinxh Urë mbi 3.5 Ton min. 1 (një),
- b. Pajisje (*kompjuter*) për kontrollin dhe testimin (*diagnostikimin*) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit min. 1 (një),
- c. Pajisje e testimit për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për mjetet e rënda (*konvergjencës së mjeteve*) min. 1 (një)
- d. Repart motorrik për kontrollin e motorrave me bango-provë, pajisje kontroll injektorësh, sistemit ftohës dhe testate min. 1 (një)

- e. Repart xhenerik min. 1 (një)
- f. Repart elektroaut min. 1 (një)
- g. Mjet transportues për transportin e mjeteve të rënda deri në servis pa pagesë min. 1 (një)  
(pronësi ose me qera ose me kontrate bashkëpunimi)

**Shënim:** Për pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g)**, si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambiente, për përmbushjen e shërbimeve të kërkuara në përputhje me specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kërkuara në këtë kërkesë për kualifikim, bazohet edhe në nevojën për mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitetet teknike që lidhen me gadishmërinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin në kohë dhe në cilësi të kontratës objekt prokurimi.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to” dhe në Udhëzimin nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**2.3.6** Operatori ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira një objekt (*servis*) për realizimin e kontrates, të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit për realizimin e kontratës, dhe të ketë territor të mjaftueshëm për parkimin e mjeteve për kohën që është e nevojshme. Në rastin e ndodhjes së servisit jashtë territorit të Bashkisë Fier, operatori ekonomik do të marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje të automjeteve që kanë nevojë për shërbime.

**Shënim:** Për pikën **2.3.6** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.6** duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin .

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që përpara vlerësimit të ofertave, të verifikojë në vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe të gjitha ambjentet e servisit të sipercituara, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të kërkuara.**

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”. Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtarite që lidhen me to” dhe në Udhëzimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtarite që lidhen me to” dhe në Udhëzimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se të gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, që do të përdoren për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë të reja dhe prodhim sipas standarteve të CE **ose ekuivalente me to**, dhe se operatori ekonomik merr përsipër garancinë e pjesëve të këmbimit për jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj, nga data e montimit ose vendosjes, në përputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion

Pjesët e këmbimit të certifikuara sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Me anë të kësaj deklarate synohet që pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 12 muaj garanci.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve, përkatësisht:

- Certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) ose ekuivalente të saj
- Certifikatë ISO 14001:2015 për menaxhim mjedisi (të vlefshme) ose ekuivalente të saj.
- Certifikatë ISO 45001:2018 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ose ekuivalente të saj.

e vlefshme, për objektin që prokurohet (*të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara*), të lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertues vetë paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikime vetë kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti / enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 "*Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë*".

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdher të Titullarit AK të Autorizuar me Nr.3588 Prot. date 18.03.2026 "*Mbi ngritjen e grupit të Punës*

*per identifikimin e nevojës, hartimin e termave të referencës së shërbimit dhe specifikimeve teknike, testimin e tregut dhe përlogaritjen e fondit limit, si dhe hartimin e kërkesave të vecanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të autoveturave të Bashkisë Fier”, i cili ka përgatitur specifikimet teknike, kriteret e vecanta të kualifikimit që lidhen me kapacitetin teknik dhe përlogaritjen e fondit limit, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

*Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.*

**Njësia e prokurimit:**

---